

MBROJTËSI

Vëllimi IV - Nr. 2 ... drejtësi për të gjithë

www.kosovopolic.com



SHPK-Mundësi të barabarta për të gjithë
Pozita e femrës në SHPK



Marsi në rajonin e Mitrovicës



**FILLON ZBATIMI I LIGJIT
PËR SIGURINË
E KOMUNIKACIONIT
RRUGOR**

Ligji i aprovuar në dhjetor të vitit 2007, që ka për qëllim një siguri më të mirë në komunikacionin rrugor, filloi të zbatohet në Republikën e Kosovës.

A do të shqyrtohet mirëqenia e pjesëtarëve të SHPK-së?



Siguria e qytetarëve duhet të jetë më parësore se sa politika



Shkurti historik

Ngjarjet që e përcollën Kosovën në muajt e parë të këtij viti doemos se do të shënohen në historinë e popullit të Kosovës, e sidomos muaji shkurt.

Në shkurt të vitit të kaluar, negociatori Martti Ahtisaari shpalosi në Prishtinë propozimin për zgjedhjen e statusit final të Kosovës. Këtë vit, pikërisht më 17 shkurt u bë shpallja e koordinuar e pavarësisë së Kosovës e që pasoi me njohjen e rreth 40 shteteve.

Të gjitha këto aktivitete në një mënyrë ose tjetër reflektuan edhe në gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Kosovë.

Të gjitha përgatitjet që kishte bërë policia në planet e veta operative kishte ardhur koha që t'i realizonte në teren. Derisa në Kosovë, disa ditë para dhe pas shpalljes së pavarësisë mbretëronte një atmosferë festive, zyrtarët policor u ishin përveshur punës që situata e sigurisë të jetë në nivelin e duhur. E tërë kjo u arrit në frymën e bashkëpunimit me institucionet tjera që janë përgjegjëse për siguri si KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut, e natyrisht edhe me qytetarët e Kosovës që treguan një dinjitet të lartë gjatë kësaj faze të rëndësishme për Kosovën.

Kjo ishte një sfidë mjaft e madhe për tu përballuar. Një numër mjaft i madh i mediave botërore kishin ardhur ditë më herët për të përcjellur këtë ngjarje historike. Ekipet e tëra televizive me repute botërore kishin montuar ditë më herët pajisjet e tyre për emetime të drejtpërdrejta nga Kosova. Me fjalë të tjera tërë bota kishte kthyer sytë nga Kosova.

Kjo nënkuptonte për të gjithë në një përgjegjësi të shtuar.

Plani operativ "Statusi", që ishte përgatitur më herët për një menaxhim sa më të mirë të situatës së sigurisë gjatë kësaj periudhe kohore filloi së zbatuari më 15 shkurt. Ky plan opera-

tiv megjithatë nuk nënkuptonte angazhime të jashtëzakonshme të policisë (derisa nuk paraqitej nevoja), por veprimtari të rregullt policore me vigjilencë të shtuar.

Objektivë e policisë në këtë periudhë ishte mbrojtja e jetës së qytetarëve, mbrojtja e pronës së tyre, mbajtja e rendit dhe qetësisë publike, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, rritja e patrullimeve policore sidomos ato në këmbë me qëllim të një komunikimi dhe bashkëpunimi më të mirë me qytetarë dhe ngritjes së ndjenjës së sigurisë tek ata.

Edhe në kuadër të analizave të bëra nga policia ishte e qartë se realiteti i ri i krijuar në Kosovë nuk do të mirëpritej nga të gjithë. Një sërë protestash dhe akte tjera të dhunshme e kundërligjore i përcollën ditët pas 17 shkurtit.

Një pjesë e ngjarjeve që pasuan para dhe pas shpalljes së pavarësisë janë trajtuar në kuadër të temës kryesore dhe temave tjera që janë shtjelluar në këtë edicion të revistës.

Nga shkrimet e tjera, në vend të rubrikës së profilit të oficerit do të mund të lexoni shkrimin për rolin e femrës në SHPK. Pozita e femrës në policinë demokratike e në kudër të tyre edhe në SHPK, është e pazëvendësueshme. Kjo bazohet në nevojat e shërbimit për një profesionalizëm të lartë dhe mundësisë të barabartë për të gjithë. Si temë e veçantë e trajtuar këtë numër të "Mbrojtësit", është edhe ajo për ligjin mbi sigurinë e komunikacionit rrugor që ka filluar të zbatohet në Kosovë. Në këtë shkrim janë përfshirë disa nga risitë që sjell ligji si dhe problemet që priten gjatë zbatimit të tij nga policia dhe institucione të tjera.

Ajo se çfarë na pret në tani është që të vazhdojmë së bashku në përmbushjen e misionit dhe vizionit tonë si një polici e shtetit më të ri në botë.



Buletini informativ i policisë në Kosovë është botim i SHPK-së dhe policisë së UNMIK-ut.

Botues

Njësitë i Redaksisë,
Zyra e Komisarit për Media,
SHP i Policisë, Prishtinë

Redaktor

Arbër Beka
VSAT: 038 504 604 - 2699
Tel.: 038 5080 1237
Mob.: 044 146 696
arber.beka@kosovopolicie.com
arberbeka@gmail.com
revistambrojtesi@gmail.com

Fotograf

Hakan Ugurlu
www.pbase.com/hugurlu
SERHAT ALLKAN
VSAT: 2323
Mob.: 044 416 106

Disajner

Çajup Kajtazi
Bashkim Përçuku
VSAT: 1046/1145
Mob.: 044 315 985
049 500 003
çajup.kajtazi@kosovopolicie.com
bashkim.perçuku@kosovopolicie.com

Asistentët e Redaktorit

Drin Gjonbalaj
Renata Marijanac



MBROJTËSI MAJ 2008

2 INTERVISTË

SHPK – Mundësi të barabarta
për të gjithë
Pozita e femrës në SHPK sot

5 SINDIKATA E SHPK-së

A do të shqyrtohet mirëqenia
e pjesëtarëve të SHPK-së?

6 FILLON ZBATIMI I LIGJIT

Intervistë me toger Qamil Behramin

10 17 SHKURT 2008

Një epokë e re për Kosovën

14 SIGURIA NË MITROVICË

Marsi në rajonin e Mitrovicës

16 PËRKRAHET SHPK-ja

Kontingjenti i policisë turke vazhdon
të ndihmojë SHPK-në

18 KRONIKË

Policia kufitare e SHPK-së
profesionale dhe e vendosur
në luftimin e krimit

20 EULEX

Shefi i Misionit të EULEX-it
viziton SHPK-në

22 IN MEMORIAM

Kolonel Sherif HAJRA, SHPK # 1076
30 Maj 1947 – 25 Shkurt 2008

25 FOTO LAJME

MË GJERËSISHT →

INFORMATË SHITESË NGA REDAKSIA:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të UNMIK-ut dhe SHPK-së

SHPK - Mundësi të barabarta për të gjithë

Pozita e femrës në SHPK

Shërbimi Policor i Kosovës në pajtim me kompetenca që ka, promovon dhe krijon mundësi të barabarta, harton politikat duke u bazuar në barazi në gjinore, miraton masa dhe ndërmerr aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj. Për të kuptuar më shumë për pozitën e femrës në SHPK, ekipi Mbrojtësit intervistoi gjeneral major Atifete Jahjagën.



S i i gjeti 8 Marsi femrat e punësuar në SHPK?

Gjeneral Jahjaga: Fillimisht do kisha thënë se 8 marsi është dita ndërkombëtare e grave. Kjo ditë festohet në shumë vende të botës. Dita ndërkombëtare e grave është historia e grave të zakonshme që kanë bërë histori. Kjo ditë është rrënjësuar si luftë shekullore e

grave për të marrë pjesë në shoqëri në nivel të barabartë me burrat. Ideja e ditës ndërkombëtare të grave erdhi në fillim të shekullit 20 që në botën e industrializuar si pjesë e zgjerimit, rritjes së popullsisë dhe ideologjive radikale. Ndaj sot në këtë ditë ne të gjithë nderojmë punën e tyre të madhe në edukimin dhe ecurinë për përgatitjen e një brezit të ri me virtytet më të mira

për të ecur përpara në rrugën e trasuar.

Që nga themelimi i këtij shërbimi, pjesëtareve të të njëjtit me rastin e 8 Marsit iu është kështuar vëmendje e posaçme.

Në çdo njësi organizative organizoheshin pritje solemne duke rikujtuar luftën e grave për drejtat e tyre që kanë sot. Edhe sivej kjo ditë e tyre është festuar në mënyra të ndryshme.

Komanda kryesore e shërbimit ka organizuar drekën solemne për gjitha femrat që punojnë në kuadër të kësaj komande. Solemnisht ishte edhe në njësi tjera – regjionet dhe stacionet policore.

Sa jeni të kënaqur me procesin e përfshirjes së femrës në SHPK?

Gjeneral Jahjaga: Nëse nisemi nga fakti se çfarë mentaliteti ka mbretëruar, nuk është pritur se me rastin e themelimit të këtij shërbimi paraqitet numri kaq i madh i femrave. Sot në kuadër të SHPK-së, nga numri i përgjithshëm 14% janë femra. Sipas plan-programit mbi punësimin e femrës në këtë shërbim është paraparë që numri i tyre të jetë 15% nga numri i përgjithshëm. Prandaj, na ka mbetur që në këtë drejtim akoma të punojmë. Femrat të cilat punësohen pranë këtij shërbimi, fillimisht trajnohen dhe edukohen që këtij shërbimi ti japin kualitetin e ri në veprim. Me këtë, ne jemi duke i ndjekur përvojat e vendeve të zhvilluara. Përndryshe, këto femra janë të sistemuara në të gjitha njësitë ekzistuese të këtij shërbimi.

Numri i konsideruar i tyre është graduar, kështu që në kuadër të këtij shërbimi femrat janë përfaqësuar me të gjitha gradat ekzistuese, respektivisht nga grada i rreshterit e deri tek ajo e gjeneralit. Nuk duhet anashkaluar faktin se në punën e këtij profesioni femra tregoi aftësitë dhe shkathtësitë sikur edhe meshkujt. Interesimin e madhe të femrave për këtë punë mundemi ta shikojmë nga disa aspekte. Psh. Nga aspekti i barazisë gjinore kjo paraqet shansin që femra të dëshmojnë si të barabarta në punën “e meshkujve”. Ky profesion deri tani ka qenë për femra i paarritshëm, kurse çdo gjë e re, sipas definicionit është atraktive.

Si e vlerësoni pozitën e femrës në SHPK-në?


Gjeneral Jahjaga: Femrat kosovare kanë entuziazëm dhe aftësi për ta përzgjedhur instrumentin dhe institucionin përkatës. Pjesëmarrja e femrës në radhët e SHPK-së përfshinë në mënyrë të veçantë të drejtën e tyre për të punuar në mënyrë të barabartë me kolegët e tyre meshkujt. Në

çastin kur e kemi pranuar këtë detyrë, kemi qenë në dijeni se do të ballafaqohemi me probleme të ndryshme. Përfshirja e femrave në SHPK, nuk do të thotë se ato nuk do të përfshihen apo ndërhyjnë në rastet me rrezikshmëri të lartë. Përkundrazi, femrat në raste të tilla mund të jenë në rend të parë dhe të ballafaqohen me problemin.

Përveç tjerash, femra në polici merr pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave që ka ky shërbim. Ajo është sistemuar në gjitha njësitë organizative të shërbimit (nga niveli lokal, regjional e deri në Komandën Kryesore). Kryen punët nga më të ndërlikuara dhe me përgjegjësi.

Sa jeni të kënaqur me mekanizmat brenda SHPK-së që punojnë për barazi gjinore?

Gjeneral Jahjaga: Ky shërbim është themeluar para tetë vitesh dhe ende konsiderohet si shërbim i cili dita-ditës është duke u aftësuar dhe profesionalizuar në kuptimin e realizimit të suksesshëm të të gjitha punëve dhe detyrave të punës që ka.



Më parë thash se në kuadër të këtij shërbimi, nga numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të tij, 14% janë femra të përkatësive të ndryshme nacionale. Sipas plan-programit kjo përqindje duhet të jetë 15%. Femra në polici është përfaqësuar në gjitha njësitë ekzistuese të saj. Numri i konsideruar i tyre është graduar dhe mbanë pozita të ndryshme, nga udhëheqësi i vijës së parë, kryesuesi i Departamentit e deri tek ndihmës i Zv.Komisarit. Na mbetet që në një kohë të afërme ta përmirësojmë gjendjen e tanishme. Pa dyshim, ligji e drejta, nuk krijon vetvetiu, si e tillë, barazinë shoqërore, barazinë sociale, politike midis njerëzve apo gjinive. Barazia de jure duhet bërë barazi de facto, pra legjisllacioni duhet zbatuar. Sanksionimi me ligj i kësaj barazie shënon, mund të them, themelin, hapin e parë, ndonëse mjaft të rëndësishëm për ndërtimin e godinës së demokracisë së barazisë reale. Sanksionimi i barazisë më ligj është hapi i parë shumë i rëndësishëm në ndërtimin e demokracisë.

Sa i përket kësaj pyetjeje do e kisha shtuar se hapin e rëndësishëm në këtë drejtim, pa dyshim paraqet aplikimi i Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1325. Kështu që, përfshirja kërkon zotim dhe pjesëmarrje të të dy gjinive, meshkujve dhe femrave. Ky shërbim në këtë drejtim ka rolin e rëndësishëm të veçantë.



A do të shqyrtohet mirëqenia e pjesëtarëve të SHPK-së?

Sindikata e Shërbimit Policor të Kosovës me shkresë iu drejtua të gjitha institucioneve, përkatësisht Kryetarit të Kosovës, Kryeministrit të Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Shefit të UNMIK-ut, Udhëheqësit të EULEX-it, Ministrit të Punëve të Brendshme, Komisarit të Policisë dhe Zv. Komisarit të SHPK-së për përmbushjen e kërkesave të SSHPK-së.

"Sindikata e Shërbimit Policor të Kosovës, kohë më parë ka kërkuar nga të gjitha institucionet e vendit përmbushjen e kërkesave, siç janë: siguri shëndetësor për pjesëtarët e SHPK-së, ngritja e pagës për të gjithë pjesëtarët e shërbimit (për ata të cilët kurrë njëherë nuk ka pas ngritje), siguri i shujtës për pjesëtarët e shërbimit, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit/siguri i transportit dhe pagesa e rrezikshmërisë dhe punës jashtë orarit.

Mos përmbushja e këtyre kërkesave (përveç ndërrimit të natës, e cila u realizua), solli sot pjesëtarët e këtij shërbimi të jenë raste sociale, duke pas parasysh se çmimet e artikujve elementar jetësor kanë shënuar ngritje enorme. Edhe ngritja e çmimit të energjisë – rrymës është duke shkaktuar pakënaqësi tejet të madhe, andaj Sindikata e SHPK-së kërkon anulimin e rritjes të çmimit të rrymës.

Kryesia Qendrore e Sindikatës të Shërbimit Policor të Kosovës kërkon nga të gjitha institucionet e vendit që në afat sa më të



Sindikata e SHPK-së adreson edhe njëherë kërkesat te institucionet vendore dhe ndërkombëtare

Ndër të tjera Sindikata e SHPK-së kërkoj që menjëherë të aplikohet Ligji i Policisë, duke mos pritur afatin kohor për fillimin e implementimit të këtij ligji

shkurt të përmbushin kërkesat e theksuara më lartë, sepse jemi e vetmja polici në botë që tash e nëntë vite që nuk ka siguri shëndetësor dhe nuk ka pas ngritje të pagës (duke veçuar këtu ngritjen e pagës vetëm për gradat e larta).

Kjo gjendje e tashme është e pa qëndrueshme dhe e pa dureshme.

Pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës patën mirëkuptim deri më tash, mirëpo frikohemi se këtij mirëkuptimi është duke i ardhur fundi.

Pjesëtarët e këtij shërbimi ishin dhe janë krenar për misionin fisnik që kanë dhe çdo ditë këtë po e dëshmojnë përmes profesionalizmit, duke u ofruar qytetarëve

të vendit siguri dhe duke mbrojtur integritetin e vendit.

Mirëpo, ata me të drejtë çdo ditë shtrojnë pyetje se a mendon në këtë vend dikush për ta, duke pas parasysh se ata duke kryer punën e tyre u nënshtrohen rreziqueve dhe sakrificave të përditshme dhe se në shoqëri nuk ka më të rrezikuar se pjesëtarët e këtij shërbimi, ndërsa nuk gëzojnë të drejtën elementare – sigurimin shëndetësor që çdo polici në botë e gëzon.

Tashmë paga e ultë e pjesëtarëve të këtij shërbimi nuk mbulon as nevojat më elementare të tyre, andaj Sindikata e SHPK-së kërkon nga të gjitha institucionet e vendit që urgjentisht të shqyrtojnë pozitën tejet të rëndë materiale të pjesëtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës, që menjëherë të aplikohen benefitet e parapara me Ligjin e Policisë, duke mos pritur afatin kohor për fillimin e implementimit të këtij ligji, sepse shkalla e pakënaqësisë tek pjesëtarët e shërbimit ka arritur kulminacionin.

Nga dita në ditë, shërbimin e lëshojnë një numër i konsiderueshëm i oficerëve, kuadro të dëshmuara dhe profesionalisht të ngritura, për të cilët ka nevojë ky shërbim, ndërsa askush nuk qan hallin për këtë.

Shpresojmë se brengat e lartcekura, më në fund institucionet tona shtetërore e demokratike do ti marrin në konsideratë si prioritet – thuhet në fund të kësaj kërke të Sindikatës së SHPK-së.



**Ligji i aprovuar
në dhjetor të
vitit 2007, që ka
për qëllim një
siguri më të mirë
në komunika-
cionin rrugor,
filloi të
zbatohet në
Republikën
e Kosovës.**

FILLON ZBATIMI I LIGJIT për sigurinë e komunikacionit rrugor

Deri tani të gjitha gjrobat dhe kërkesat për kundërvajtje që janë bërë nga policia janë bërë me ligje të vjetruara që ishin aprovuar rreth 20 vite më parë. Duke pasur parasysh zhvillimin e teknologjisë dhe të infrastrukturës në përgjithësi, ishte parë e nevojshme që të bëhen ndryshime në legjislacionin që mbulon këtë fushë për një siguri më të mirë në komunikacionin rrugor.

Këto ndryshime pritet që t'i sjellë ligji për sigurinë e komunikacionit rrugor që është përpiluar në bazë të standardeve evropiane të sigurisë në komunika-

cion.

Ky ligj është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës dhe do ta zëvendësojë ligjin me të cilin SHPK ka punuar deri tash. Policia ditëve në vijim do të merret me vetëdijesimin e qytetarëve, si dhe me njoftimin e tyre rreth ligjit të ri dhe dhënien e vërejtjeve.

Ligj është përpiluar në bazë të standardeve më të larta të sigurisë në komunikacionin rrugor në Evropë, ndërsa policia kërkon nga qytetarët që përveç njohurive që marrin nga ata gjatë fushatës së informimit lidhur me risitë që sjell ky ligj, qytetarët

do të njoftohen për këtë edhe përmes mediaeve dhe formave të tjera. Në kuadër të fushatës së informimit për qytetarë ishte edhe konferenca e organizuar në Shtabin e Përgjithshëm të Policisë në Prishtinë. Pjesëmarrësit në këtë konferencë të shtypit që vinin nga Ministria e Post dhe Telekomunikacionit, Gjykata për kundërvajtje dhe nga SHPK-ja.

Aty u dhanë disa shpjegime për këtë ligj duke treguar se ndryshimet ishin të nevojshme për të pasur një gjendje më të mirë sa i përket sigurisë së komunikacionit rrugor.

Xhevdet Smakiqi - këshilltar i ministrit të post dhe telekomunikacionit, vlerësoi prioritetet që ka vënë ministria ku ai punon sa i përket zbatimit të këtij ligji.

“Ligji sjell risi dhe është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe para aprovimit ka kaluar në zyrën për integritet të BE-së. Ministria e post telekomunikacionit ka vënë prioritet që të punojë në tri aspekte: në zbatimin e këtij ligji, në mirëmbajtjen dhe rregullimin e infrastrukturës rrugore dhe janë duke u përgatitur edhe formularët dhe udhëzimet e reja sa i përket licencimit të auto-shkollave në Kosovë si dhe programin e aftësimit të kandidatëve për shofer për t’ju përshtatur këtyre standardeve.

Ne do të angazhohemi poshatu edhe për një fushatë mediale në bashkëpunim edhe me MPB-në dhe atë të ministrinë Arsimit për vetëdijesimin e qytetarëve lidhur me risitë që sjell ky ligj.” – theksoi z.Smakiqi.

Dënime më të buta se ato nga ligji i vjetër

Në pyetjet e gazetarëve rreth ndëshkimeve në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, kryetari i Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë – z. Mehmet Neziri iu përgjigj se dënimet janë më të buta nëse krahasohen me ligjin e vjetër: “Është ligj që përfshin veprat e parapara në komunikacionin rrugor dhe dënimet për ato rregulla. Unë mendoj se dënimet tani janë më të

buta se ato që kanë qenë më parë, psh të kundërvajtja kemi shumë dënime që janë më të vogla sesa që kanë qenë më parë. Një risi tjetër që sjell ky ligj është se tani kemi edhe pikët negative përveç gjobës që i shqiptohet. Nëse kundërvajtësit i grumbullohen 9 pikë negative brenda 36 muajve atëherë të njëjtit i merret patentë-shoferi dhe ai duhet t’i nënshtrohet edhe njëherë testit për aftësim. Më parë kemi pasur edhe dënimet me burgim e tani më nuk kemi dënime të tilla për kundërvajtje në komunikacion.” - theksoi Z. Neziri.

Mirëpo dënimet për tejkalim të shpejtësisë janë më të mëdha dhe atë duke pasur parasysh se një numër mjaft i madh i kundërvajtësve dënohen pikërisht për këtë gjë.



Për të pasur një pasqyrë më të mirë rreth përgatitjeve që policia ka bërë dhe do të bëjë gjatë ditëve të ardhshme, ekipi i Mbrojtësit intervistoi toger Qamil Behramin – shef i administratës në Drejtorinë e trafikut rrugor në SHPK.

Si është duke shkuar procesi i përgatitjeve për zbatimin e ligjit për sigurinë e komunikacionit rrugor?

Toger Behrami: SHPK-ja ka filluar së pari me përgatitjet teknike të nevojshme për të filluar pas kësaj me zbatimin e këtij ligji. Kjo fillon me përgatitjen e formularëve të dënimeve dhe formave tjera të nevojshme që janë të p a r a p a r a me këtë ligj. Në kuadër të kësaj hyjnë

edhe ligjëratat që do të mbahen nëpër njësitë e trafikut në tërë Kosovën. Në këtë mënyrë të gjithë oficerët e SHPK-së do të njoftohen me përmbajtjen e këtij ligji. E tërë kjo do të përcillet edhe me një fushatë informimi për të gjithë qytetarët e Kosovës për risitë që sjell ky ligj. Në kuadër të kësaj fushate oficerët kanë filluar të ndalojnë shoferët të cilët nuk i respektojnë këto rregulla të reja që ka sjellë ky ligj.

Pasi ju ishit pjesëmarrës në grupin punues për hartimin e ligjit, sakanëqenët e nevojshme ndryshimet që janë bërë me këtë ligj?

Toger Behrami: Ligji është ndryshuar për shkak të vjetërsisë duke pasur parasysh se ka qenë i vjetër mëse 20 vjet. Bazuar në këtë është shfaqur nevoja që të ndryshohet duke

futur në ligjin e ri edhe standardet evropiane të komunikacionit rrugor të cilat standarde dhe rregulla shumë shtete të perëndimit i implementojnë që një kohë të gjatë. Me këtë ligj pritet të ngritet niveli i sigurisë së pjesëmarrësve në komunikacion dhe qëllimi kyç është që të zvogëlohet numri i aksidenteve në komunikacion. Vetëm në vitin 2007 ne kemi pasur mëse 17000 aksidente prej të cilave 139 kanë qenë me pasoja fatale. Te drejtuesit e automjeteve veç kanë filluar të vërehen ndikimet e këtij ligji në aspektin pozitiv.

A mendoni se do të hasni në vështirësi gjatë zbatimit të këtij ligji?

Toger Behrami: Ligji ka disa risi që nuk kanë qenë përpara. Një pjesë e këtij ligji është marrë nga ligji për sigurinë e komunikacionit rrugor nga Kroacia, dhe kam frikë se në disa raste do të kemi vështirësi në implementimin e tij, psh. dhënia e vërejtjeve me shkrim që është e paraparë me këtë ligj, te ne kjo është risi dhe nga kjo rrjedh menjëherë pyetja se ku do të regjistrohet ajo vërejtje, sa vërejtje mund ti shqiptohen brenda një viti apo 6 muajve,

pastaj si do të përcillen këto vërejtje nga zyrtarët policor.





Që të mund të përcillen duhet të instalohet një bazë e të dhënave që të mund të përcille të dhënat e drejtuesve që kanë marrë vërejtje, dhe e njëjta vlen edhe për pikët negative që janë risi e këtij ligji. Pra të gjitha këto çështje teknike duhet të plotësohen dhe përgatiten së pari në mënyrë që të zbatohet me sukses ky ligj.

A keni kontaktuar psh. me oficerët nga policia e Kroacisë pasi që më parë e cekët se një pjesë e ligjit është marrë nga ai vend që të merrni shembuj konkret se si zbatohen nenet e veçanta që janë risi te ne?

Toger Behrami: Kam kontaktuar me një oficerë kroate që punon si monitoruese këtu. Kam kërkuar që të mundësohet që një grupi oficerëve të shkojnë në Kroaci që për disa ditë të shkojnë në Kroaci dhe të shikojnë në praktikë se si zbatohet ligji për sigurinë e komunikacionit rrugor atje. Në Kroaci psh. kur një person e merr patentë shoferin bashkë me të i epet edhe një karton të cilin

drejtuesi është i obliguar që ta mbajë me vete e në atë karton personi zyrtar i shënon vërejtjet.

A janë njoftuar të gjithë oficerët e policisë lidhur me risitë e këtij ligji?

Toger Behrami: Unë mendoj se ende duhet të punohet në njoftimin e oficerëve për risitë e këtij ligji. Drejtoria e trafikut ka bërë një shkresë për të gjithë komandantët e trafikut që të fillojë me ligjërata lidhur me risitë e këtij ligji. Një zgjidhje e mirë do të ishte caktimi i një ekipe prej dy apo tre oficerëve të cilët do të mbanin ligjërata në rajonin e tyre dhe kjo metodë të vazhdojë edhe në rajonet e tjera respektivisht nëpër stacione policore. Jemi duke punuar edhe në përgatitjen e formularëve unik për tërë Kosovën që do të shpërndaohen nëpër rajone.

Kur fillon regjistrimi i pikëve negative që janë të parapara me këtë ligj?

Toger Behrami: Regjistrimi i

pikëve negative fillon tre muaj pasi që ligji hyn në fuqi dhe mendoj se deri të përfundojë kjo kohë edhe ne do të kemi bazën e të dhënave të patet shoferëve dhe do të kemi mundësi që t'i regjistrojmë këto pikë negative dhe masat tjera ndëshkuese. Gjykata, policia dhe Ministria e Drejtësisë do të përcjellin këto të dhëna. Në këtë bazë të të dhënave mendojmë që të gjithë oficerët do të kenë qasje në të gjitha rajonet në mënyrë që oficeri nga Prishtina do të jetë i njoftuar nëse tjetri në Pejë psh i ka shqiptuar ndonjë masë drejtuesit të njëjtë.

Cili do të ishte mesazhi juaj për të gjithë oficerët e SHPK-së?

Toger Behrami: Mesazhi im do të ishte që të gjithë oficerët të respektojnë ligjet dhe këtë ligj të ri të trafikut rrugor. Ne duhet të jemi shembulli i parë për të gjithë qytetarët se si duhet të respektohet ligji dhe rregullat e komunikacionit rrugor.



17 SHKURT 2008 NJË EPOKË E RE PËR KOSOVËN

Rrugë të mbushura me flamuj, fytyra të gëzuara e lot gëzimi, sheshe përplot me qytetarë që mbanin në duar flamuj kombëtar dhe të shteteve të ndryshme evropiane, dhe pa incidente - kështu mund të përshkruhet fillimi i ditës së diel të 17 shkurtit, ditë kjo që u shënua në historinë e Kosovës.

Kjo datë shënoi përfundimin e një procesi shumëvjeçar e që u kremtua me shpalljen e koordinuar të pavarësisë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Derisa ditë më herët (megjithëse nuk ishte caktuar ndonjë datë zyrtarisht) qytetarët anembanë Kosovës kishin filluar që të festonin me flamuj në duar, zyrtarët policor kishin filluar që të bënin përgatitjet e tyre që gjithçka të shkojë pa incidente. Planet, të cilat ishin përgatitur muaj më parë, kishte ardhur koha që të

fillonin të realizoheshin varësisht nga situata që do të paraqitej në teren.

Plani operativ "Statusi", ishte përgatitur më herët për një menaxhim sa më të mirë të situatës së sigurisë. Ai filloi së zbatuari të premten (15.02.2008). Dhoma e incidentit në qendrën operative të Shtabit të Përgjithshëm të Policisë ishte vendosur dhe zyrtarët e operativës po përcillnin me vëmendje situatën që po zhvillohej në tërë Kosovën. Ky plan megjithatë nuk nënkuptonte angazhime të jashtëzakonshme

të policisë (derisa nuk paraqitej nevoja), por veprimtari të rregullt policore me vigjilencë të shtuar.

Objektivë e policisë ishte mbrojtja e jetës së qytetarëve, mbrojtja e pronës së tyre, mbajtja e rendit dhe qetësisë publike, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, rritja e patrullimeve policore sidomos në ato në këmbë me qëllim të një komunikimi dhe bashkëpunimi më të mirë me qytetarë dhe ngritjes së ndjenjës së sigurisë të qytetarët.



Një angazhim të veçantë kishte edhe zyra për informim e SHPK-së. Në bashkëpunim me rajonet policore ata u kujdesën për një transparencë duke pasur parasysh numrin e madh të medimeve ndërkombëtare që kishin ardhur ditë më herët për të përcjellë këtë ngjarje të rëndësishme për Kosovën. Me qindra intervista që u dhanë atë ditë nga policia (mbi 150 intervista vetëm nga zëdhënësi i SHPK-së Veton Elshani), si në Grand Hotel në Prishtinë ku ishte vendosur qendra mediale, ashtu edhe nga zyrat për informim publik në rajone, ndihmuan në ndalimin e qarkullimit të thashethemeve që veç kishin filluar të përfliteshin. Kjo edhe ishte strategjia e zyrës për informim së SHPK-së, për një qasje pro-aktive në menaxhimin e kësaj situate. Edhe rajoni i Prishtinës kishte bërë përgatitjet e nevojshme për këtë datë të shënuar. Zyrtarët nga ky rajon e kishin parasysh se manifestimi qendror do të bëhej pikërisht aty, andaj më herë kishin hartuar planet e ndryshme për siguri dhe për qarkullimin e automjeteve në kryeqytet. Në këtë aspekt, meritë janë gjithsesi edhe qytetarët kosovar që treguan se me të vërtetë dinë të festojnë me dinjitet në shtetin më të ri në botë.





Ngjarjet që pasuan pas shpalljes së pavarësisë – sfidë për policinë

Plani operativ "Statusi" kishte për qëllim që në Kosovë të mbretërojë një gjendje e qetë dhe stabile. Zyrtarët policor e kishin të qartë se nuk do të merreshin vetëm me kremtimin por edhe me palët e pakënaqura për vendimet politike për shpalljen e koordinuar të pavarësisë. Bashkësia e vendbanimeve serbe u kishte bërë thirrje atyre që më 18 shkurt të marrin pjesë në tubimet politike në Mitrovicë, Shtërpçë, Ranilluk etj. Policia po e përcillte me vëmendje situatën që po zhvillohej në teren.

Të gjitha këto protesta nuk kaluan pa incidente. Dy vendkalimet kufitare, Kosovë - Serbi në vendin e quajtur Jarinjë (Leposaviq) dhe Banjë (Zubin Potok) u sulmuan nga grupe protestuesish dhe pasi u demoluan atyre ju dha flaka. Për fat të mirë nuk kishte të lënduar në njerëz, ndërsa njësitë e KFOR-it u vendosën në ato pika kufitare e pas krijimit të kushteve aty vazhduan punën edhe

policia, mirëpo jo edhe shërbimi doganor.

Kjo filloi të paraqiste probleme në fusha të ndryshme e sidomos në luftimin e kontrabandës me mallra dhe gjësende të tjera. Krahas dëmtimit të buxhetit të Republikës së Kosovës nga shmangja e tatimit, mund të rrezikohet edhe shëndeti i qytetarëve kosovar pasi që shumë mallra që hyjnë në Kosovë nuk kontrollohen nga inspekcioni sanitar. Në një konferencë për shtyp të mbajtur nga Aleanca Kosovare e Biznesit u prezantuan rreth 15 artikuj me afat të skaduar e që dyshohet se këta artikuj ushqimorë kanë hyrë nëpërmjet këtyre pikave. Megjithatë njësitë të policisë dhe të shërbimit doganor (njësitë mobil të tyre) janë angazhuar në pika të ndryshme në rajonin e Mitrovicës të cilat mendohet se mund të përdoren nga kontrabanduesit, prapë mбетet ende punë për tu bërë në këtë fushë. Në anën tjetër një ekip i veçantë i hetuesve të SHPK-së (task force) janë caktuar dhe janë duke udhëhequr hetimet lidhur me dj-

egien e këtyre vendkalimeve kufitare dhe incidenteve tjera që ndodhën atë ditë në këto pika kufitare.

Këta hetues janë duke përdorur provat materiale si incizimet, fotografive dhe deri tani janë identifikuar mbi 20 persona të dyshimtë të përfshirë në këtë incident kriminal. Hetuesit policor janë në kontakt të vazhdueshëm me prokurorin ndërkombëtar i cili është në krye të këtij hetimi dhe janë në përfundim të përgatitjes së kallëzimit penal që do të dorëzohet prokurorisë.

Mirëpo, këto nuk ishin pikat e vetme kufitare që u ballafaquan me probleme. Më 25 shkurt, në pikën kufitare të Mutivodës (vendkalimi kufitar me Serbinë) një masë e njerëzve prej 100 -150 personave që dyshohet të kenë qenë rezervist nga Serbia, të pakënaqur me statusin e Kosovës kishin ardhur nga drejtimi i Medvegjës tek Porta numër 4 (Mutivodë) dhe sulmuan policët të cilët ishin aty duke kryer detyrat e tyre.



Njësiti për mbështetje operative (NJMO-ja) nga Prishtina kishin arritur në vendin e ngjarjes së bashku me njësite të KFOR-it. Masa e njerëzve që kishte ardhur nga ana serbe kishte ardhur të organizuar. Me vete ata kishin kamion të mbushur me gurë, zjarrfikës dhe automjetin e ndihmës së parë. Ata filluan që të gjuaj-

nin me gurë në drejtim të oficerëve të policisë kosovare. Njësiti special ishte i detyruar që në dy raste të përdor gazin lotsjellës në mënyrë që të zmbrops sulmin e protestuesve të cilët ishin jashtëzakonisht agresiv. 19 oficerë të SHPK-së pësuan lëndime kryesisht nga goditja me gurë të cilët vinin nga ana e

protestuesve që ishin afuar afër kufirit kosovar. Oficerët e NJMO-së me këtë rast treguan një performancë shumë të mirë dhe profesionale. Duke mos rënë në provokime nga protestuesit, policët treguan se niveli i përgatitjes së tyre për kontrollimin e turmave është në nivel të lartë.





Marsi në rajonin E MITROVICËS

Një ditë pas shpalljes së deklaratës për pavarësinë e Kosovës, në veri të Mitrovicës, u regjistruan një sërë protestash të mbajtura nga qytetarë të komunitetit serb në shenjë kundërshtimi të kësaj deklarate dhe shprehjes së pakënaqësisë për realitetin e ri të krijuar në Kosovë. Këto protesta shënuan një vazhdimësi protestash të njëpasnjëshme.

Pa dyshim se situata e rëndë e krijuar në Mitrovicë (pas shpalljes së pavarësisë), ka zanafillën e saj më 14 mars 2008, ku gjatë një proteste të dhunshme të filluar në orët e hershme të mëngjesit në rrugën "Filip Vishnjq", një grup protestuesish (100-150 persona), demoluan me forcë dy portat e rrethojave dhe më pas u futën në objektet e gjykatave të qarkut dhe asaj komunale në Mitrovicë.

Njësitë e specializuara të policisë së UNMIK-ut, bënë përpjekjet e tyre maksimale për të ndaluar protestuesit e rebeluar të cilët në linjë të parë kishin inkuadruar kryesisht gra ndërsa nga prapavija në vazhdimësi po sulmonin forcat policore me mjete të forta të metalit dhe gurë. Më vonë numri i përkrahësve të protestuesve të dhunshëm u rrit në 300. Ata depërtuan përmes kordonit të vendosur policor dhe më pas demoluan edhe portën hyrëse të

oborrit të gjykatave.


Për situatën e krijuar udhëheqësit policor të rajonit të Mitrovicës, njoftuan përfaqësuesin rajonal të UNMIK-ut, i cili në atë kohë kishte zhvilluar bisedë me përfaqësuesit politik në veri të Mitrovicës pa mundur të arrijë ndonjë marrëveshje.

Mëngjesin e së hënës (17 mars 2008), policia e UNMIK-ut, e ndihmuar dhe përkrahur edhe nga KFOR-i, kishte zbatuar një urdhër të lëshuar nga PSSP i KB në Kosovë, për rikthimin e objekteve të gjykatave nën përkujdesjen e UNMIK-ut. Intervenimi policor rezultoi me arrestimin e 53 personave, në mesin e të cilëve kishte edhe gra, të cilët ishin takuar brenda lokaleve të gjykatave.

Një incident ishte shënuar gjatë transportimit të personave të arrestuar.

Një grup i personave të dhunshëm, kishin sulmuar kordonin policor i cili po transportonte të arrestuarit, me qëllim të lirimit të tyre me forcë nga arresti policor. Një përpjekje e tillë e dhunshme, ka rezultuar me arratisjen e 21 personave të arrestuar më herët.

Pak qaste më vonë, para objekteve të gjykatave po tuboheshin njerëz në shenjë kundërshtimi të intervenimit të ligjshëm të policisë dhe KFOR-it.



Qindra protestues të mbledhur para ndërtesës së gjykatave kanë filluar të hedhin gurë dhe më pas edhe përzierje ndezëse (koktej molotovi) drejt pjesëtarëve të policisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it, me ç'rast u dëmtuan dy automjete të UNMIK-ut dhe dy të KFOR-it.

Turma e njerëzve të dhunshëm nuk ndali me kaq, më pas ndodhën disa shpërthime të granatave të dorës dhe kishte edhe shumë gjuajtje me armë të zjarrit. Situata kishte marrë përmasat e tensionimit të plotë ndërsa reagimi i forcave Policore dhe atyre të KFOR-it, bëhej në bazë të zhvillimit edhe të vet situatës.

Pas intensifikimit të sulmeve nga ana e grupeve të dhunshme me mjete të ndryshme shpërthyes dhe armë zjarri të llojeve të ndryshme, policia u urdhërua që të bënte tërheqje nga veriu i Mitrovicës, ndërsa situatën ta merrte nën kontroll KFOR-i. Tërheqja e forcave policore ishte bërë për shkak të sigurisë së tyre personale dhe pamundësisë për t'i rezistuar një sulmi të përmasave të tilla.

Si pasojë e këtyre akteve kriminale, bilanci i të lënduarve kishte arritur në dhjetëra.

Në bazë të shënimeve që merreshin në teren, shifra e policëve ndërkombëtar të lënduar kishte arritur në 63 ndërsa 48 prej tyre i takonin forcave të njësive të specializuara të policisë së UNMIK-ut. Një pjesëtar i SHPK-së, jashtë detyrës zyrtare dhe në rroba civile, është lënduar rëndë gjatë këtyre protestave dhe i njëjti ishte dërguar në trajtim mjekësor jashtë Kosovës.

Kynol Iyor (25 vjeçar), pjesëtar i forcave speciale të policisë së UNMIK-ut, nga kontingjenti Ukrainas, kishte humbur jetën në kryerje të detyrës zyrtare, si pasojë e lëndimeve të rënda të pësuar gjatë akteve të dhunës.

Në një konferencë të jashtëzakonshme për



Kynol Iyor

shtyp që u mbajt një ditë pas këtyre ngjarjeve, Komisari i Policisë - Larry Wilson e cilësoi këtë vdekje si humbje të madhe:

"Në mëngjesin djeshëm në veri të Mitrovicës, një polic i UNMIK-ut është vrarë. Emri i tij ishte Kynol Iyor. Ai kreu detyrën e tij dje jashtëzakonisht mirë dhe i kushtoi atij me jetë. Ne kemi filluar procesin e hetimeve për të zbuluar ata që e kryen këtë vrasje dhe të tjerët që lënduan oficerët tjerë të policisë së UNMIK-ut"- theksoi z.Wilson duke falënderuar doktorët e KFOR-it francez për përpjekjet e tyre heroike për të shpëtuar jetën e këtij oficeri.

Në ditën e protestave të dhunshme, me një urdhër operativ të lëshuar nga komanda kryesore e policisë në Prishtinë, për shkakë sigurie ishte suspenduar edhe veprimtaria e pjesëtarëve të SHPK-së, në stacionin veri, deri në normalizimin e situatës.

Dy ditë më pas, pjesëtarët e policisë të stacionit veri, u kthyen në stacionin policor në kryerje të detyrave të zbatimit të ligjit dhe rendit publik në qytet, ndërsa forca të KFOR-it, të cilat akoma vazhdojnë të sigurojnë objektet e gjykatave, mbajnë përgjegjësinë për sigurinë e përgjithshme në veri të Mitrovicës.



KONTINGJENTI I POLICISË TURKE VAZHDON TË NDIHMOJË SHPK-në

Përveç ndihmës në fushën e sigurisë me forca policore që janë të inkuadruar në kuadër të policisë së UNMIK-ut në Kosovë, kontingjenti i policisë turke është duke dhënë ndihmë edhe në fusha tjera të rëndësishme siç është ajo e trajnimit.

Një numër i konsiderueshëm i oficerëve tanimë kanë vijuar disa trajnime në Turqi për teknologjinë informative, por trajnimi i radhës që vjen si ndihmë SHPK-së nga Turqia është ai në fushën e inteligjencës dhe vëzhgimit.

Në kuadër të kësaj, ditë më herët, Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti dhe stafi i tij pritën në një vizitë pune në zyrën e tij 5 ekspertë të lartë policor të fushave të inteligjencës dhe vëzhgimit nga policia shtetërore e Turqisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte që ata ti shohin më për së afërmi nevojat e SHPK-së për trajnime si dhe ngritja e bashkëpunimit në mes këtyre dy institucioneve.

Gjeneral Nënkolonel Ahmeti e çmoi lartë vizitën e ekspertëve turq dhe i njoftoi

për sektorë të caktuar të cilët kanë nevojë për këto trajnime. Ai i njoftoi të pranishmit për çështjen e sigurisë, të arriturat e SHPK-së dhe projektet e planifikuara për periudhën në vazhdim duke u fokusuar në trajnimet për sektorët e caktuar.

Grupi prej këtyre ekspertëve theksoi se në kuadër të përkrahjes dhe bashkëpunimit për projektet e trajnimit shteti i Turqisë edhe për vitin 2008 ka paraparë mbështetjen me trajnimet të specializuara për zyrtarët e SHPK-së.

Në kuadër të këtij projekti janë paraparë të trajnohen mbi 300 zyrtar në trajnime të ndryshme që do të mbahen në Kosovë dhe disa në Turqi.

Njëri ndër këto trajnime në fushën e inteligjencës i cili është i paraparë në kuadër të projekti ("Konceptet dhe vëzhgimet fundamentale të Inteligjencës") tanimë ka filluar .

Ky trajnim që zgjatë dy javë është i paraparë për zyrtarët që punojnë në njësite si ajo Kundër-terrorizmit, krimit të organizuar dhe inteligjencës. Në fund të takimit të dyja palët shprehën gatishmërinë për ruajtjen dhe ngritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Në vazhdimësi të këtij projekti janë paraparë të trajnohen mbi 300 zyrtarë në trajnime të ndryshme që do të mbahen në Kosovë dhe në Turqi.



SHPK-së i dhurohen 500 aparate për matjen e alkoolit

Ky donacion do të ndihmojë shumë për ngritjen e efikasitetit dhe do ti kontribuojë rritjes së sigurisë së trafikut rrugor

Kontingjenti policor i Turqisë në emër të policisë kombëtare turke i dhuroi SHPK-së 500 (pesëqind) aparat për matjen e alkoolit (alko-test).

Zv.Komesari i policisë së UNMIK-ut Mustafa TEKIN-BAS në mënyrë ceremoniale i dorëzoi këtë donacion Zv. Komisarit Sheremet Ahmetit.


Me këtë rast z.Ahmeti i falënderoi për ndihmën e dhënë duke theksuar se kjo nuk është hera e parë që SHPK-ja, ka pranuar ndihma nga policia turke. Gjithashtu ai tha se ky donacion do të jetë një ndihmesë e madhe për rritjen e sigurisë në trafik.

Shërbimi Policor i Kosovës vlerësoi lartë këtë donacion duke theksuar se tani e tutje do të rritet edhe më shumë efikasiteti dhe kjo do të jetë një preventivë në parandalimin e aksidenteve dhe sigurisë në trafik.

Policia deri më tani ka pasur rreth 140 alko-teste dhe me pranimin edhe të 500 të tjerëve do të jetë shumë më e përgatitur teknikisht dhe do të tregoj rezultate edhe më të mëdha në teren.

Shpërndarja e tyre do të bëhet në mënyrë të organizuar nga Drejtorati i Trafikut nëpër të gjitha regjionet dhe paraprakisht do të mbahet një trajnim i shkurtër lidhur me përdorimin e këtij lloji të alko-testit.





POLICIA KUFITARE E SHPK-së

**profesionale dhe
e vendosur në
luftimin e krimit**



Tanimë qytetarët e Kosovës e dinë se sa janë profesional oficerët nga policia kufitare e SHPK-së. Këtë tani e dinë edhe personat e dyshimtë të cilët janë zënë “me presh në duar” dhe presin vendimin e gjykatës për veprimet e tyre ilegale.

Në bashkëpunim me qytetarët, policia kufitare zbulon një numër të konsiderueshëm të dokumenteve të falsifikuara

Pikërisht këto suksese të aritura forcojnë më shumë bashkëpunimin me qytetarë drejt luftimit të aktiviteteve të kundërligjshme në Kosovë. Se sa janë të dedikuar këta oficerë e tregojnë rezultatet e punës së tyre në të gjitha pikat kufitare dhe

në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Një rast i ngjashëm ishte edhe ai i datës 8 Prill me ç’rast katër qytetarë të Kosovës tentuan që nëpërmes aeroportit të Prishtinës të fluturojnë për në Bukuresht, Rumani. Gjatë kontrollimit të dokumentacionit të tyre është dyshuar se ato janë jo të rregullta. Ky dyshim i dërgoi hetuesit nëpër pistën e hetimeve për të identifikuar më vonë edhe personin i cili i kishte përgatitur këto dokumente false.

Njësitë e Hetuesisë së Policisë Kufitare me qendër në Prishtinë në bashkëpunim me Departamentin e Krimit dhe Stacionin Policor Veriu në Prishtinë reagues menjëherë dhe në konsultim me prokurorin me dyshimin e bazuar se personat e dyshimtë kanë kryer vepër penale të Falsifikimit të Dokumenteve dhe Kontrabandim me Migrant, bastisën dy lokacione në lagjen Kodra e Trimave. Gjatë bastisjes ata zbuluan një numër të konsiderueshëm të provave materiale dhe arrestuan dy persona të dyshimtë.

Derisa një i dyshimtë u arres-

tua me dyshimin e bazuar se ka të bëjë me kontrabandë me Migrant dhe falsifikim të dokumenteve, gjatë bastisjes së shtëpisë së tij policia hasi në rezistencë nga ana e vëllait të tij dhe më këtë rast me akuzën pengim i personit zyrtar në kryerje të detyrës zyrtare është arrestuar edhe ky person.

Gjatë bastisjes u gjetën dhe konfiskuan dokumente të cilat dyshohen të jenë të falsifikuara si: pasaporta, patentë-shoferë, viza, leje të njoftimit, librezë ushtarake, holograme, certifikata të ndryshme si dhe mjete të ndryshme për falsifikimin dhe prodhimin e dokumenteve si një numër i madh i vulave për vulosjen e dokumenteve (SHPK, UNMIK etj) vula apostile, unaza për kapjen e fotografive në dokumente të ndryshëm, printer, skaner, aparat për detektim të dokumenteve, sasi e te hollave prej 3720 Euro dhe 20 dollar amerikan etj.

Gjatë bastisjes së njërit nga të dyshimtët poashtu është gjetur edhe një revole e tipit BLOË e kalibrit 8mm.





Shefi i Misionit të EULEX-it viziton SHPK-në

"Synimi i SHPK-së - integrimi në Strukturat ndërkombëtare të sigurisë"
- Gjeneral nënkolonel Sh.Ahmeti

Ditën e fundit të muajit mars, Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti së bashku me udhëheqësit e shtyllave të ndryshme në kuadër të SHPK-së, priti udhëheqësin e misionit të EULEX-it në Republikën e Kosovës – z.Yves de KERMABON.

Udhëheqësi i Misionit të EULEX-it në Kosovë u zotua për një bashkëpunim të mirë në mes SHPK-së dhe anëtarëve të Misionit të EULEX-it në Kosovë:

"Qëllimi i misionit të EULEX-it është që të vendosim një zbatim sa më të mirë të ligjit në Kosovë. Ne duhet të vendosim një bashkëpunim sa më të mirë së bashku duke vendosur marrëdhënie të mira në mes anëtarëve të EULEX-it dhe pjesëtarëve të SHPK-së."- theksoi ndër të tjera Z.Kermabon në këtë takim.

Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti duke i uruar mirëseardhje shefit të misionit të ardhshëm në Kos-

ovë e siguroi atë se SHPK-ja do të vazhdojë në kryerjen e detyrave të tyre drejt përmbushjes së misionit dhe vizionit të saj:

"Ne do të vazhdojmë me angazhimet tona në shërbim të qytetarëve të Kosovës, duke u zhvilluar në këtë mënyrë në bazë të parimeve demokratike, standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës."- theksoi Zv. Komisari Ahmeti duke cekur se SHPK-ja pret një bashkëpunim të mirë me misionin e EULEX-it.

Ai ndër të tjera theksoi se një ndër synimet e Policisë së Kosovës është edhe krijimi i partneritetit me strukturat e Misionit të Bashkimit Evropian dhe integrimi i SHPK-së në Strukturat ndërkombëtare të sigurisë përfshirë këtu edhe bashkëpunimin ndërkombëtarë policor, kurse për shtrirjen

e misionit të ardhshëm të EULEX-it, Kermabon u zotua se ky mision do të shtrihet në tërë Kosovën.

Pas përfundimit të takimit delegacioni i EULEX-it në krye me Yve de Kermabon vizituan Qendrën Operative të SHPK-së si dhe Dhomën për menaxhimin e incidenteve në këtë Qendër.



Siguria e qytetarëve duhet të jetë më parësore se sa politika

Pas realitetit të ri politik të krijuar në Kosovë, një numër i pjesëtarëve të SHPK-së të komunitetit serb (rajoni i Prishtinës dhe ai i Gjilanit) deklaruan se nuk do të pranojnë urdhra nga SHPK-ja por vetëm nga policia e UNMIK-ut. Duke pasur parasysh se procesi i tranzicionit kishte përfunduar nëpër ato stacione respektivisht rajone policore, një kërkesë e tillë ishte e papranueshme për SHPK-në. Mbi 200 oficerë të SHPK-së të nacionalitetit serb u suspenduan me pagesë sepse ata refuzuan të respektojnë zinxhirin komandues të SHPK-së. Në ndërkohë që hetimet për oficerët e SHPK-së që janë të suspenduar është duke i udhëhequr Inspektorati Policor i Kosovës.

Pas zhvillimit të këtyre ngjarjeve, Komisari dhe Zv.Komisari i Policisë ju drejtuan këtyre oficerëve me një letër të hapur duke cekur se një situatë e tillë është e rëndë:

Në këtë letër u cek se që nga viti 1999, pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës kanë qenë të përkushtuar, si shërbyes të zellshëm, ata kanë dhënë kontributin e tyre për të mbrojtur dhe shërbyer komunitetet tuaja. "Gjatë disa ditëve të kaluara, ka qenë e nevojshme që të suspendohen më tepër se 200 pjesëtarë

të SHPK-së. Ka qenë e qartë në diskutimet që kemi pasur me këta polic se ata nuk kanë dashur të ndodhin këto suspendime, megjithatë ata kanë shpjeguar se nuk kanë zgjidhje në këtë çështje për shkak të kërcënimeve të bëra ndaj tyre, familjeve të tyre dhe shtëpive të tyre. Kjo është një situatë e rëndë që nuk mund të lejohet të vazhdoj." – thuhej më tutje në këtë letër të hapur.

"Shërbimi Policor i Kosovës ka nevojë që këta pjesëtarë të kthehen në pozitat e tyre. Komunitetet në tërë Kosovën kanë nevojë që këta pjesëtarë të kryejnë detyrën e tyre për të cilën janë betuar se do të jenë në shërbim të qytetarëve. Ata për shume vite kanë mbrojtur qytetarët, dhe qytetarët duhet

t'i mbështesin ata që të vendosin për të vazhduar detyrat e tyre. Ata duhet të lejohen që të kryejnë detyrat e tyre pa frikë, kërcënim apo frikësim."

"Si Komisar i Policisë dhe Zëvendës Komisar i Policisë, i bëjmë thirrje qytetarëve të Kosovës që të mbështesin këta policë dhe t'i nxisin që të kthehen në detyrat e tyre. Këta policë duhet ta dinë se kanë një të ardhme me Shërbimin Policor të Kosovës.

Atyre duhet t'u bëhet me dije se komuniteti i tyre e mbështet punën e tyre. Siguria e qytetarëve duhet të jetë më parësore se sa politika."- përfundonte letra e hapur e nënshkruar nga Komisari i Policisë Larry Wilson dhe Zv. Komisari - Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti.

Letër e hapur nga Komisari dhe zv. Komisari i policisë



IN MEMORIAM

Kolonel Sherif Hajra, ndërroi jetë papritmas, nga një sulm i fortë në zemër ditën e hënë, 25 shkurt 2008 rreth orës 15:00 min, derisa ishte në kryerje të detyrës zyrtare.

Kolonel Sherif HAJRA, SHPK # 1076
30 Maj 1947 – 25 Shkurt 2008

Kolonel Hajra, që nga mosha 21 vjeçare ishte përcaktuar për të ardhmen e tij në shërbim të qytetarëve. Në vitin 1968, është inkadruar në shërbimin policor për të punuar me nder e respekt si polic patrullues, profesor i kriminalistikës, udhëheqës dhe inspektor i lartë i hetimeve të krimit deri në vitin 1990, kur me dhunë largohet prej pune nga autoritetet e atëhershme.

Për të përmbushur misionin e tij të shenjtë dhe fisnik për të cilin ishte përcaktuar qysh në moshën e re, i bashkëngjitet Shërbimit Policor të Kosovës në gjeneratën e pestë, në prill të vitit 2000. Pas përfundimit të akademisë policore, caktohet në detyrë zyrtare në stacionin policor jugor në Mitrovicë.

Si oficer i SHPK-së, ka dhënë kontributin e tij profesional duke shërbyer me dinjitet dhe përkushtim në njësitë patrulluese, njësinë e trafikut, por edhe si oficer i sigurimit të ndërtesës rajonale të policisë në Mitrovicë, edhe përkundër faktit se kishte përvojë të gjatë policore dhe përgatitje shkollore superiore. Ishte i diplomuar në degën e kriminalistikës në Zagreb të Kroacisë dhe në fakultetin e sigurimit dhe vetëmbrojtjes, në Shkup të Maqedonisë.

Ata të cilët kishin të njohur aftësitë dhe mundësitë e tij prej profesionisti, i kërkuar që të ligjëronte dhe të trajnonte në praktikë oficerët e SHPK-së të gjeneratave; 11, 12 dhe 13 të këtij shërbimi në Mitrovicë.

Në muajin prill të vitit 2001, ishte caktuar të punoj hetues në njësinë e standardeve profesionale të SHPK-së pranë komandës rajonale në Mitrovicë, ndërsa pak muaj më vonë, më 1 dhjetor 2001, gradohet me gradë të rreshtit.

Në kohën kur shërbimi policor po krijonte strukturat e saja në ngritjen e kuadrove për të marrë më tepër përgjegjësi, në muajin dhjetor të vitit 2002, ai është caktuar si zëvendës komandant i stacionit jugor në Mitrovicë me gradë të togerit, për të kaluar në postin e komandantit të këtij stacioni në muajin qershor të vitit 2004 me gradë të kapitenit, ku edhe udhëhoqi



dhe menaxhoi me sukses këtë stacion policor deri në janar të vitit 2005.

Me një urdhër emërim të lëshuar nga Komanda Kryesore e Policisë, është emëruar drejtor i drejtoratit për planifikim, zhvillim dhe inspektim pranë Komandës Kryesore të Policisë në Prishtinë, për t'u avancuar në gradën major në muajin maj 2005.

Çdo gjë që bënte ishte profesionale, punën e kryente me nderë, entuziazëm dhe etikë të lartë policore. Këto virtyte të cilat konsideroheshin të ishin arma më e fuqishme e tij, bënë që komisar i policisë së UNMIK-ut, të emëroj të ndjerin në gradë nënkolonel, në shtator 2005.

Në kohën kur Mitrovica konsiderohej të hynte në fazën më të ndjeshme të vendim marrjeve policore, në qershor 2006 Kolonel Hajra caktohet si mbikëqyrës i drejtpërdrejt i realizimit të planit operativ "Siguria e rreptë". Tre muaj më pas, me urdhër të komisarit të policisë emërohet në gradë të kolonelit dhe caktohet në postin e zëvendës komandantit rajonal të policisë për operativë në Mitrovicë. Këtë post e mbajti me përgjegjësi, përkushtim dhe profesionalizëm të lartë deri në çastet e fundit të jetës së tij.



Fatmir Hajra pranon flamurin e SHPK-së nga Maliqi

Ai pas vetes, në kujtim të përhershëm për të ka lënë bashkëshorten, vajzën dhe dy djemtë.

Lajmi për vdekjen e papritur të Kolonel Sherif Hajrës ishte tronditës, jo vetëm për familjarët dhe pjesëtarët e SHPK-së, por edhe për qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Ai u nda nga jeta në momentin kur më së shumti i duhej Mitrovicës dhe shërbimit.

Ceremonia mortore për të ndjerin dhe shprehja e përshëndetjeve të fundit u mbajt më 26 shkurt 2008 në bibliotekën e qytetit në Mitrovicë, me pjesëmarrjen e shumë qytetarëve, familjarëve, kolegëve të SHPK-së dhe përfaqësuesve të të gjitha institucioneve ndërsa, varrimi i të ndjerit u bë në orët e pasdites në vendin e tij të lindjes në fshatin Broboniq.

Ishin të shumtë ata të cilët në fjalën e fundit të ndarjes me të do të thoshin shumë nga ato fjalë të cilat nuk ia kishin thënë asnjëherë!

"I ndjeri Kolonel Hajra, është cilësuar si njeri i cili ka lënë gjurmë të pashlyera në detyrat eaktuara që nga posti i zëvendës komandantit të stacionit e deri tek zëvendës komandanti rajonal i policisë në Mitrovicë" theksoi Zëvendës Komisari për SHPK, Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti në fjalimin e tij mortor, duke shtuar se "idealet dhe figura e tij kurrë nuk do të vdesin".

Jo vetëm kaq, "Për aq kohë sa kam pasur rastin të punoj krahas të ndjerit, nuk kam arritur të kuptoj se kush nga kush po mësonte për punën policore" është shprehur Davie McInain, komandanti rajonal i policisë së UNMIK-ut, në Mitrovicë, në fjalën e tij të fundit ndarëse nga ceremonia e varrimit.

Ngushëllimet drejtuar familjarëve dhe të pranishmëve si dhe respektin për veprën dhe punën e palodhshme të të ndjerit, në emër të qytetarëve dhe kryetarit të kuvendit komunal të Mitrovicës, i shprehu zëvendës kryetari i KK Mitrovicë, zt. Ahmet Tmava.

"Mos lejo të jetosh jetën tënde si një jo profesionist"

Integriteti, përgjegjësia, pastërtia, respekti për të tjerët, kufijtë e diturisë, vetë-përmirësimi, komunikimi, bashkëpunimi dhe lidhshipja janë elementet e një profesionisti, të cilat i ndjeri Kolonel Sherif Hajra i dispononte për nga natyra e tij, ndërsa shpesh pyesja vetën: "A jemi të tjerët profesional pranë tij?!"

Nuk lejonte të vetëkënaqej me punën e tij sepse besonte se me këtë nuk do të kishte produkt të mirë me të cilin do të mburrej në fund. "Mos lejo të jetosh jetën tënde si një jo profesionist" më kujtohet të thoshte shpesh, "Ne jemi profesionist, duhet shikuar situatën dhe të merremi me situatën ashtu si e shohim" thoshte sa herë që kishim të bënim me gjëra të ndërlikuara.

Ishte i një natyre njerëzore me shumë ngrohtësi, i afërt, i dashur dhe me paqe e harmoni të plotë të kësaj bote dhe të këtij shërbimi. Nuk mungonte asnjëherë, në asnjë prej ngjarjeve të rëndësishme.

Pranë tij gjithmonë po flisim për mundësitë e zgjedhjes së problemeve. Jo, se kishte nevojë për kërkesa zyrtare apo thjesht ti bëhej qejfi për të marrë pjesë në projektet për të lehtësuar punën e policëve, por se thjesht shprehte thelbin e përkushtimit të tij policor.

Për herë të fundit unë u takova dhe fola me të ditën e hënë, më 25 shkurt, mbi urën kryesore të lumit Ibër në Mitrovicë. Më përgëzoi për punën e mirë të bërë me gazetarët e shumtë të cilët po ndiqnin ngjarjet e protestave. Ai po ashtu, më tha se do të më takonte pas përfundimit të takimit tim me gazetarë për t'më qortuar për disa imtësira. Zakonisht e bënte një gjë të tillë kur paraqitej nevoja.

Derisa unë prisja takimin me të në orët e pasdites, në zyrë u paraqit një nga asistentet e tij me sy të përplotur e më tha: "koloneli...!" Prej zërit të saj të dridhur kuptova se diçka serioze kishte ndodhur. Kolonel Sherif Hajra, ndërroi jetë papritur! Mbete i shtangur... nuk mund të paramendoja se nuk do ta takoja më në jetë!

Për një çast e gjeta veten të ulur në karrigen e punës dhe mendoja, se unë kurrë nuk gjeta momentin t'i them sa shumë kisha mësuar nga këshillat dhe përvoja e tij profesionale policore!

Përgatitur nga: Besim Hoti



Zbulohet rrjeti i falsifikatorëve në Prishtinë

Hetuesit e rajonit të Prishtinës i japin përparësi luftës kundër kriminalitetit e veçanërisht disa shqetësimeve që kohët e fundit ka pasur komuniteti në lidhje me rastet e raportuara të falsifikimit.

Njësitë policore të rajonit të Prishtinës në kuadër të intensifikimit të masave të marra në drejtim të garantimit të rendit dhe sigurisë publike si dhe goditjes së individëve dhe grupeve kriminale që kanë aktivitet, kanë organizuar punën e tyre me fokus të veçantë zbardhjen e veprave kriminale, identifikim dhe arrestimin e të dyshuarve të implikuar në ngjarjet kriminale.

Hetuesit e rajonit të Prishtinës i kanë dhënë përparësi luftës kundër kriminalitetit dhe veçanërisht disa shqetësimeve që kohët e fundit ka pasur komuniteti në lidhje me rastet e falsifikimit të ndodhura në zona të ndryshme të rajonit të Prishtinës, duke organizuar një varg operacionesh për kapjen e këtyre individëve.

Një nga këto operacione të organizuara mirë, në drejtim të kapjes së personave, për të cilët dyshohej me bazë të jenë të përfshirë në veprimtarinë kriminale të falsifikimit, u finalizua me sukses ku u arrestuan dy persona të dyshuar dhe u kon-

fiskuan një numër i madh i mjeteve dhe materialeve të dyshuara.

Pjesë e operacionit ishte edhe bastisja në një banesë të marrë me qira nga ana e të dyshuarve në lagjen Dardania të kryeqytetit ku policia ka arritur të gjej dhe konfiskoj: Pasaporta të vendit dhe të huaja, Letërnjoftime, Kartela Banke, Patentë shoferë, Libreza Veturash, Viza Schengen, Leje të ndryshme Biznesi, Dokumente nga Kadasrat, Certifikata të Lindjes, Gjendjes Martesore, Diploma të Shkollës së Mesme, Letra thirrëse nga vendet e ndryshme, Fatura të ndryshme, Dokumente të ndryshme të zbrazëta, Pajisje teknologjike për zhvillimin e veprimtarisë në fjalë, Kompjuterë, Printer, Skaner si dhe një numër i konsiderueshëm i gjësendeve të tjera që dyshohet të jenë përdorur nga të dyshuarit për falsifikimin e dokumenteve të ndryshme.

Të dyshimitit 33 dhe 20 vjeç, pas arrestimit u dërguan në qendrën rajonale të paraburgimit në Prishtinë, derisa hetuesit ti kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore

e procedurale lidhur me rastin në fjalë para se rasti t'i kaloj gjykatës.

Tre muajt e parë të këtij viti janë karakterizuar për nga rritja e ndjeshme e treguesve të punës hetimore në drejtim të kapjes së personave të dyshuar si të implikuar në veprimtari kriminale, dhe krejt kjo ka ardhur si rezultat i intensifikimit të masave policore për identifikimin, zbulimin, grumbullimin e saktë të informacioneve mbi vendstrehimin e këtyre personave, mbajtjen nën kontroll të vazhdueshëm të lidhjeve të tyre, si dhe organizimi i operacioneve të kualifikuara policore të zhvilluara për këtë qëllim.

Që nga një janari i vitit 2008 policia e rajonit të Prishtinës ka arritur të arrestoj dhe paraburgos 514 persona të dyshuar për vepra të ndryshme penale ku prej tyre 42 dyshohet të jenë të përfshirë në raste të falsifikimeve dhe mashtrimeve.

Në këto rezultate një kontribut të çmuar ka dhënë edhe komuniteti i cili në vazhdimësi me ndihmën e dhënë ka qenë përkrah policisë në luftën e pa kompromis ndaj krimit.

1



1. Fotoja tregon pamje nga takimi i radhës i Këshillit koordinues për Sundimin e Ligjit. Nga ky takim që u mbajt në Ministrinë e Drejtësisë, Këshilli Koordinues u zotuan se do të vazhdojnë me angazhimet e tyre për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

2



2. Kompania CMB Production ka filluar xhirimet për një serial të ri televiziv. Rolet kryesore dhe ngjarja është e lidhur kryesisht me punën policore. Fotoja tregon pamje të xhirimeve në Shtabin e Përgjithshëm të Policisë në Prishtinë.

3



3. Të gjithë në Kosovë kishin shfaqur interesimin për të përcjellur ngjarjet e veçanta të datës 17 shkurt 2008. Mbi 1000 media kishin ardhur të përcillnin këtë ngjarje kurse në këtë foto shihen oficerët e sigurimit të SHPK-së duke përcjellur me vëmendje fjalimin e Kryeministrit Hashim Thaqit në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008.

4



4. Në foto shihen Zv.Ministrit Punëve të Brendshme Z.Fatmir Xhelili dhe zyrtarët e lartë të SHPK-së në një takim të përbashkët për projektet e përgatitura (që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë dhe nevojat e policisë) dhe atyre që do të përgatiten për Konferencën e Donatorëve që pritet të mbahet në Qershor të këtij viti.

5



5. Në foto shihet manifestimi dhe ceremonia e organizuar nga kontingjenti i policisë turke në Kosovë. Këtë vit ata shënuan 163 vjetorin e Policisë Kombëtare turke.

Prishtinë, 17 shkurt 2008



RISI

Presim shkrimet tuaja!

Në numrin e ardhshëm të revistës **Mbrojtësi**, shkrimi më i mirë në një temë të lirë që ka të bëjë me çështje policore (suksese, probleme, sfida, bashkëpunimi me qytetarë etj), do të shpërblehet me një aparat të kafes i cili është donacion i Kontingjentit Amerikan të Policisë në Kosovë.

Shkrimi duhet të jetë përafërsisht dy faqe dhe i përcjellur edhe me foto që ndërlidhen me shkrimin tuaj.

Të gjitha shkrimet mund ti dërgoni deri më 30 maj 2008 përmes adresës elektronike:
revistambrojtessi@gmail.com ose mund ti dorëzoni në Zyrën për Informim Publik në Shtabin e Përgjithshëm të Policisë, zyra nr1.

Loja shpërblyese vazhdon

Shkrimi më i mirë do të zgjidhet nga komisioni tre anëtarësh i zgjedhur nga njësitë i redaksisë dhe do të publikohet në numrin e ardhshëm.